

NEWSLETTER

Korrik

**ALBSIG, gjithmonë
pranë klientit:
Dëmshpërblim i
shpejtë dhe
transparent.**

**Zgjidhje të dedikuara
sigurimi për çdo
aspekt të pushimeve
tuaja!**

**ALBSIG –
Lider në treg,
partner në
besim!**



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



ALBSIG, gjithmonë pranë klientit:



Dëmshpërblim i shpejtë dhe transparent



Një nga elementët që prej vitesh ka dalluar Albsig në tregun e sigurimeve është procesi i dëmshpërblimit në kohë dhe në favor të klientit. Për kompaninë, trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një përgjegjësi ndaj besimit që klientët na japin çdo ditë.


Të gjitha procedurat e ndjekura nga Albsig janë të standardizuara, transparente dhe të orientuara drejt lehtësimit të klientit. Ky model pune ka sjellë një rezultat të qartë: rritje të besimit dhe zgjerim të vazhdueshëm të bazës së klientëve besnikë, të cilët zgjedhin të mbeten me Albsig edhe pas përfundimit të një procedure dëmi.

Statistikat e fundit tregojnë se periudha mesatare për trajtimin e **dëmeve të vogla është vetëm 3 ditë**, ndërsa për dëmet me vlera më të larta procesi mbyllet mesatarisht **brenda 30 ditëve**. Ky është një tregues i qartë i përkushtimit të kompanisë për të qenë sa më pranë klientit në momentet më të rëndësishme.

Ky përkushtim reflektohet edhe në të dhënat zyrtare: sipas **Buletinit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën Janar – Korrik**, Albsig ka numrin më të ulët të dëmeve pezull (të papaguara) në treg.

Një fakt që konfirmon, në mënyrë të qartë dhe transparente, aftësinë e kompanisë për të ofruar **pagesa në kohë rekord** dhe shërbim me standarde të larta.

Për Albsig, këto rezultate nuk janë rastësore. Ato lidhen drejtpërdrejt me **kulturën korporative dhe modelin e biznesit të ndërtuar si pjesë e Grupit Kastrati**, i cili i jep kompanisë fleksibilitetin për t'u përshtatur me shpejtësi ndaj ndryshimeve të tregut dhe aftësinë për të ruajtur një rol



udhëheqës në cilësinë e shërbimeve të sigurimit.

Falë këtij modeli, Albsig ka arritur të ruajë një trend të qëndrueshëm rritjeje ndër vite, duke forcuar pozicionin e saj si një partner i besueshëm për mijëra qytetarë e biznese që kërkojnë **siguri, mbështetje dhe stabilitet financiar.**



Zgjidhje të dedikuara sigurimi për çdo aspekt të pushimeve tuaja!

Ndërsa mendoni për destinacionet dhe pushimet, Albsig ju fton të mos lini pas dore sigurinë për veten, familjen dhe gjithçka që keni të çmuar.

Me fushatën **“A e sigurove verën tënde?”**, Albsig vjen pranë jush me një gamë produktesh të menduara posaçërisht për nevojat e sezonit, duke ju dhënë mundësinë të shijoni pushimet pa shqetësime.



Sigurimi i shëndetit në udhëtim — Mbrojtje kudo që shkoni.

Një udhëtim jashtë vendit sjell gjithmonë emocion dhe eksperiencë të reja, por edhe rreziqe të paparashikuara. Polica e sigurimit të shëndetit në udhëtim nga Albsig ju ofron mbulim të plotë për urgjencat shëndetësore, shpenzimet spitalore dhe asistencë të menjëhershme kur është e nevojshme. Me këtë produkt, pushimet tuaja kthehen në kujtime të bukura, pa u rrezikuar nga situata të papritura.



Sigurimi i banesës — Qetësi, edhe kur nuk jeni në shtëpi.

Ndërsa familja është me pushime, banesa shpesh mbetet e pambrojtur ndaj rreziqeve. Sigurimi i banesës nga Albsig mbulon dëme nga zjarri, fatkeqësi natyrore, rrjedhje tubacionesh apo dëmtime të shkaktuara ndaj palëve të treta. Në këtë mënyrë, ju mund të relaksoheni duke ditur se shtëpia juaj është gjithmonë e mbrojtur.



Sigurimi i biznesit — Mbështetje në sezonin më të ngarkuar.

Sezoni turistik është momenti kur bizneset e hoteleri-turizmit funksionojnë në kapacitet të plotë. Çdo ndërprerje e aktivitetit sjell humbje të mëdha.

Për këtë arsye, Albsig ka ndërtuar paketa sigurimi të personalizuarra për hotele, bare, restorante dhe struktura të tjera akomoduese, të cilat ofrojnë mbrojtje ndaj zjarrit, përgjegjësisë civile, enëve nën presion dhe rreziqeve natyrore. Kështu, biznesi juaj vijon aktivitetin pa pasiguri, edhe në ditët më të ngarkuara të vitit.



Sigurimi online — Shpejt, thjesht dhe sigurt.

Falë platformës **albsig.al**, sigurimet nuk kanë qenë kurrë më afër. Me vetëm pak klikime, mund të blini online policat e shëndetit në udhëtim, sigurimin e banesës apo sigurimin e biznesit, në çdo moment dhe nga çdo vend. Procesi është i shpejtë, i qartë dhe transparent — asnjë pritje, asnjë procedurë e ndërlikuar.

Me Albsig, vera është vetëm për t'u shijuar. Për sigurinë kujdesemi ne.



Bli Online





ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP





Shëndeti në Udhëtim

Ju zgjidhni destinacionin për Sigurinë mendojnë Albsig.
Që të udhëtimeve tuaja sigurohuni të keni me vete
Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim.

Kujdesuni që të dhënat të jenë të sakta!
Këtu prandë jush dokumentat e vlefshëm: Kartë identiteti, Kartë krediti (ose debiti që lejon blerje online), Pasaportë.

1 Të dhënat për sigurimin

2 Pagesa

3 Pagesa

Vlera (Euro) 7

Mënyra e Pagesës

VISA


Maestro

MasterCard

paySera

ALBS1G

**Lider në treg,
partner në besim!**





ALBSIG konfirmon lidershipin në tregun e sigurimeve.

Rezultatet e publikuara për periudhën Janar — Korrik 2025 dëshmojnë edhe një herë pozicionin e fortë të ALBSIG në tregun e sigurimeve, duke e renditur kompaninë si lider në disa nga produktet kryesore.

Lidership në produktet strategjike

- **KASKO:** ALBSIG kryeson tregun me 36.16%, duke u renditur në vend të parë dhe duke konfirmuar besimin e klientëve në cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve tona.
- **PËRGJEGJËSI NDËRTUESI:** ALBSIG mban vendin e parë, duke mbështetur zhvillimin e tregut të ndërtimit me produkte të besueshme dhe transparente.
- **GARANCI:** ALBSIG siguron vendin e parë me 51.43% të tregut, një dëshmi e rolit kryesor që luajmë në ofrimin e mbrojtjes së domosdoshme për bizneset dhe partnerët institucionalë.

Rritje mbi tregun

Në tregun e përgjithshëm të sigurimeve, ALBSIG renditet në vend të dytë me **19.22%** të pjesës së tregut. Rritja prej **9.45%** krahasuar me një vit më parë është dukshëm mbi mesataren e tregut, i cili ka regjistruar një rritje prej **8.62%**.


Ky rezultat tregon qartë se ALBSIG jo vetëm që po rritet më shpejt se tregu, por edhe që po konsolidohet si një aktor dominues, i qëndrueshëm dhe inovator.

Lidershipi i ALBSIG nuk është vetëm një tregues numrash, por mbi të gjitha, pasqyrë e besimit që klientët kanë zgjedhur të vendosin tek ne. Transparenca, profesionalizmi dhe shërbimi i personalizuar mbeten themeli mbi të cilin ndërtojmë suksesin tonë.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL